



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna Drenasit
Municipality Drenas
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/01-33538 dt. 11/08/ 2026

Në bazë të nenit 52 të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 42, neni 44 pika 44.4 dhe pika 44.5 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 12 pika 12.2 dhe nenit 21 pika 21.2 të Rregullores së punës të Kuvendit të Drenasit, kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

Th ë r r e t

mbledhjen e **shtatë** të Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet më **datë: 18.08.2026** e cila do të fillojë në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e bordit të drejtorive, (kati tretë) i Komunës Drenasit.

Për mbledhje propozohet ky:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politike dhe Financa i datës: 22.07.2026.
2. Propozim vendim për miratimin e Draft Planit Komunal për Transportin Lokal në Komunën e Glogocit për periudhën 2026–2031.
3. Propozim Vendim për themelimin e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores të punës së Kuvendit të Komunës së Drenasit.
4. Propozim Vendim për Themelimin e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Drenasit.
5. Raport rreth korrije –shirjeve në territorin e Komunës së Drenasit për vitin 2026.
6. Pyetje dhe përgjigje.
7. Të ndryshme.

Drenas, 11.08.2026



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Burim Bajupi



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-33179 dt. 10/08 / 2026

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 22.07.2026, e cila filloi në orën 10:10.

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KPF-së: Burim Bujupi (kryesues i Kuvendit), Fitore Morina-Hoxha (PDKRLL), Selman Çallapeku (PDKRLL), Pajtime Berisha (PDK), Arigon Sinani (PDK), Egzona Tërdevci (VV) dhe Arbër Halilaj (BD).

Të pranishëm ishin edhe: Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci dhe Drejtori i Financave, Enver Hoxha.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Burim Bujupi**, kryesues i Kuvendit.

RENDI I DITËS:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e dt.18.06.2026;
2. Raporti i punës së Kryetarit dhe qeverisjes lokale për periudhën janar–qershor 2026;
3. Raporti financiar për periudhën janar–qershor 2026;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, pasi përshëndeti të pranishmit, hapi diskutimin për ndryshimin dhe plotësimin e rendit të ditës.

Fjalën e mori **Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci**, i cili paraqiti një propozim-vendim për shpalljen interes të përgjithshëm të një prone komunale. Kryetari sqaroi se kjo pronë planifikohet për ndërtimin e objektit të ri të Qendrës për Punë dhe Mirëqenie Sociale, pasi objekti ekzistues është në gjendje të rëndë teknike.

Egzona Tërdevci theksoi se, duke qenë se raporti i punës së Kryetarit është paraparë për seancën e ardhshme, ajo propozon që në këtë seancë të përfshihet një raportim i veçantë nga Drejtoria e Infrastrukturës, si drejtoria me vëllimin më të madh të projekteve kapitale. Gjithashtu, ajo sugjeroi që pika "Të ndryshme" të mbetet e pandryshuar, por të shtohet një pikë e re e rendit të

ditës për pyetje dhe përgjigje drejtuar ekzekutivit. Sipas saj, asamblistët duhet t'i parashtrojnë pyetjet me shkrim dhe t'i pranojnë përgjigjet në të njëjtën formë, me qëllim që të ketë më shumë qartësi.

Kryesuesi, **Burim Bujupi** sqaroi se, pika "Të ndryshme" e përfshin këtë mundësi, mirëpo e udhëzoi anëtarën që këtë propozim ta paraqesë zyrtarisht në seancën e Kuvendit, ku pas votimit të anëtarëve mund të përfshihet në rendë të ditës.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci shtoi se, nëse ka mundësi, znj. Tërdevci, të na tregosh se çfarë duhet të ndajmë prej raportit të punës. Ne mbajmë raport dy herë në vit, edhe me qytetarët, para Kuvendit, për punën që ka bërë ekzekutivi dhe komuna. Raport ekstra për infrastrukturë nuk bëjmë.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hodhi në votim këtë rend dite. Ky rend dite rekomandohet për Kuvend. Për votuan 7, abstenime 0, kundër 0.

Kryesuesi, Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e parë. **(1) Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i dt. 18.06.2026.** Pika e parë e rendit të ditës kalon. Për votuan 7, abstenime 0, kundër 0.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e dytë **(2) Raporti i punës së Kryetarit dhe qeverisjes lokale, janar–qershor 2026.** Pasi nuk ka diskutime dhe ky është vetëm një raport, nuk hidhet në votim. Kalojmë te pika e tretë.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e tretë **(3) Raporti Financiar, janar–qershor 2026** dhe e hapi atë për diskutim.

Egzona Tërdevci tha se, nuk e di nëse është e mundur t'i nxjerrim shpenzimet e gjyqit dhe të vendimeve të përmbartimit, sepse ndoshta u intereson edhe asamblistëve të tjerë.

Drejtori i Financave, Enver Hoxha, u përgjigj se mund ta bëjmë për të gjitha kategoritë. Meqenëse me emër e mbiemër dalin shumë, mund t'ju përgatisim një raport se sa janë marrë në investime kapitale dhe sa në mallra e shërbime. Nuk është problem, ose ua dërgoj në e-mail.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci shtoi se, të gjitha i keni në Thesar dhe mund t'i shihni, sepse edhe ne nga Thesari i marrim.

Arbër Halilaj, e ngriti si shqetësim problemin e vazhdueshëm me ujin. U pa që nuk ka përgjegjësi nga ata, sepse zyrtarët e KRU-së nuk erdhën në seancë. Unë mendova që duhet të ketë një zgjidhje, siç është ligji që i rregullon shërbimet e ujit dhe Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU), i cili edhe e mbikëqyr, edhe e licencon KRU-në si operator. Në dispozitat ndëshkimore dhe administrative ka hapësirë të mjaftueshme ku shihet se janë bërë shkelje, dhe ofruesi i shërbimeve është përgjegjës e fajtor për këto shkelje. Te pika dy e rregullores thotë se ofruesi i shërbimeve është fajtor dhe obligohet të paguajë gjokat

administrative nga 20,000 deri në 50,000 euro nëse nuk i respekton kushtet e licencës për standardet e shërbimit të tij, duke shkaktuar rrezik për shëndetin apo jetën e njerëzve. Domethënë, kjo është shkelje nëse nuk i furnizon qytetarët me ujë, ndërsa në anën tjetër i faturon rregullisht. Puna është që, kur ke licencë për një shërbim, ke mbrapa edhe përgjegjësi e dispozita ndëshkimore. Mund ta diskutojmë edhe në asamble, por tani është momenti i duhur për të parë nëse mund të bëjmë edhe diçka tjetër.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, u përgjigj se ne jemi duke shqyrtuar mundësinë e padisë për diskriminim ndaj qytetarëve tanë për ujin e pijshëm. Për këtë çështje, dënimet i shqipton ARRU-ja dhe vendimet i merr ARRU-ja; ne nuk marrim asgjë. Ujësjiellësi e ka obligim ligjor ta bëjë infrastrukturën, sepse merr financa nga ne sepse merr financime nga ne.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi pasi nuk pati diskutime të tjera, e konsideroi të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në orën 10:25.

Procesmbajtësja: Fakete Hoti

Lekturoi: Nikelinda Bujupi

Kryesuesi i Kuvendit

Burim Bujupi





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01 Nr. 400/01 - 33131 dt. 10/08/ 2026

Në mbështetje të nenit 58, paragrafi 1, nënparagrafi h, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72, pika h, të Statutit të Komunës së Drenasit, si dhe nenit 6 paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor, me propozim të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, Kryetari i Komunës paraqet këtë:

PROPOZIM - VENDIM

Për miratimin e Draft Planit Komunal për Transportin Lokal në Komunën e Glogocit për periudhën 2026–2031.

Neni 1

I propozohet Kuvendit të Komunës së Drenasit miratimi i Draft-Planit Komunal për Transportin Lokal në Komunën e Glogocit për periudhën 2026–2031.

Neni 2

Draft-Plani Komunal për Transportin Lokal në Komunën e Glogocit është hartuar nga Komisioni i emëruar me Vendimin e Kryetarit të Komunës, Nr. 01-400/01-9519, të datës 13.03.2026. Plani është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe pasi ka kaluar procedurat e dëgjimit publik te parapara me ligj, dhe i paraqitet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi janë përgjegjës Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.

Neni 4

Ky Propozim-vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Glogocit dhe pas përfundimit të procedurës së kontrollit të ligjshmërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.



Kryetari i Komunës:

Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Me përfundimin e periudhës së vlefshmërisë së Planit Komunal për Transportin Lokal në Komunën e Glllogocit, si dhe në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, konkretisht me nenin 6, paragrafin 2, të Ligjit Nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor, është paraqitur nevoja për hartimin dhe miratimin e një plani të ri.

Qëllimi i këtij Propozim-Vendimi është miratimi i Planit Komunal për Transportin Lokal të Udhëtarëve (PKTL) në Komunën e Glllogocit, si dokument strategjik dhe planifikues për organizimin, zhvillimin dhe menaxhimin e transportit publik të udhëtarëve në territorin e Komunës.

Miratimi i këtij Plani synon krijimin e një sistemi të qëndrueshëm, efikas dhe të sigurt të transportit publik urbano-periferik, rritjen e mbulueshmërisë së rrjetit të transportit, përmirësimin e qasjes së qytetarëve në shërbimet publike, si dhe ngritjen e cilësisë, sigurisë dhe besueshmërisë së shërbimeve të transportit.

Nëpërmjet zbatimit të PKTL-së, Komuna synon të harmonizojë planifikimin lokal me politikat kombëtare në fushën e transportit, të përmirësojë m

obilitetin e qytetarëve dhe të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social të Komunës.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01 Nr. 400/01-33532 dt. 11/08/2026

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1, nën paragrafi h i Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72, të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 11, 12, 40 të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës"), nenit 34, pika 34.6, të Statutit të Komunës së Drenasit Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e ardhshme të aprovojë këtë:

P r o p o z i m V e n d i m

Për themelimin e Komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Drenasit.

Neni 1

Me këtë Propozim Vendim i propozohet Kuvendit të Komunës themelimi i Komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Drenasit në këtë përbërje:

1. _____ -Kryesues;
2. _____ -Anëtar;
3. _____ -Anëtar;
4. _____ -Anëtar;
5. _____ -Anëtar;

Neni 2

Komisioni për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Drenasit, ka për detyrë të shqyrtojë Rregulloren aktuale të Punës së Kuvendit të Komunës së Drenasit, të identifikojë dispozitat të cilat kanë nevojë për ndryshim dhe/ose plotësim, të propozojë ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme në përputhje me legjislacionin në fuqi, të bashkëpunojë me Kryesuesin e Kuvendit, anëtarët e Kuvendit dhe strukturat përkatëse të Komunës gjatë hartimit të ndryshimeve dhe plotësimeve, të përgatisë Draft-Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Punës së Kuvendit dhe ta procedojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Komunës së Drenasit

Neni 3

Mandati i Komisionit fillon nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi dhe përfundon me përmbushjen e detyrave të përcaktuara me këtë Vendim.

Neni 4

Komisioni, pas përfundimit të punës, i paraqet Kryesuesit të Kuvendit të Komunës dhe Kuvendit të Komunës draftin për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Drenasit, së bashku me arsyetimin përkatës.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Komuna e Drenasit me qëllim të harmonizimit dhe përmirësimit të Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Drenasit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nevojat e funksionimit të Kuvendit, Kryetari i Komunës përmes këtij propozim vendimi i propozon Kuvendit të Komunës themelimin e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e saj.

Komisioni do të shqyrtojë dispozitat ekzistuese dhe do të përgatisë propozimet përkatëse për ndryshime dhe plotësime, të cilat do t'i procedojë për shqyrtim dhe miratim nga organet kompetente si dhe synon që procesi i ndryshimit dhe plotësimit të Rregullores së Punës së Kuvendit të realizohet në mënyrë profesionale, gjithëpërfshirëse dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nevojat e funksionimit të Kuvendit të Komunës së Drenasit, andaj për këtë arsye, propozohet miratimi i këtij propozim vendimi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01 Nr. 400/01-33536 dt. 11/08/2026

Në bazë të nenit 58, paragrafi 1, nën paragrafi h i Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72, të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 11, 12, 40, të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës"), nenit 34, pika 34.6, të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e ardhshme të aprovojë këtë:

P r o p o z i m V e n d i m

Për themelimin e Komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Drenasit.

Neni 1

Me këtë Propozim Vendim i propozohet Kuvendit të Komunës themelimi i Komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Drenasit në këtë përbërje:

1. _____-Kryesues;
2. _____-Anëtar;
3. _____-Anëtar;
4. _____-Anëtar;
5. _____-Anëtar;

Neni 2

Komisioni për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Drenasit, ka për detyrë që të shqyrtojë Statutin aktual të Komunës së Drenasit, të identifikojë dispozitat të cilat kanë nevojë për ndryshimin dhe/ose plotësim, të propozojë ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme në përputhje me legjislacionin në fuqi, të bashkëpunojë me strukturat dhe njësitë përkatëse të Komunës gjatë hartimit të ndryshimeve dhe plotësimeve, si dhe të përgatisë draft-statutin për ndryshimin dhe/ose ndryshimin e Statutit të Komunës dhe ta procedojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Komunës së Drenasit.

Neni 3

Mandati i Komisionit fillon nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi dhe përfundon me përmbushjen e detyrave të përcaktuara me këtë Vendim.

Neni 4

Komisioni, pas përfundimit të punës, i paraqet Kryesuesit të Kuvendit të Komunës dhe Kuvendit të Komunës draftin për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit, së bashku me arsyetimin përkatës.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.


Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Komuna e Drenasit me qëllim të shqyrtimit dhe harmonizimit të Statutit të Komunës së Drenasit me legjislacionin në fuqi dhe nevojat e funksionimit të Komunës, Kryetari i Komunës përmes këtij propozim vendimi i propozon Kuvendit të Komunës themelimin e Komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit.

Komisioni do të shqyrtojë dispozitat ekzistuese dhe do të përgatisë propozimet përkatëse për ndryshime dhe plotësime, të cilat do t'i procedojë për shqyrtim dhe miratim nga organet kompetente, andaj për këtë arsye, propozohet miratimi i këtij propozim vendimi.